



22/03/2022

Lezhë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Zmeja”

Operacioni nga Seksioni për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me Komisaritet e Policisë Mirditë dhe Lezhë. Vihen në pranga 2 shtetas. Sekuestrohen drogë dhe armë zjarri. Në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative se me një automjet që lëvizte në drejtim të Mirditës, po transportonin lëndë narkotike, në afërsi të fshatit Jezull, Mirditë, u organizua dhe u finalizua operacioni policor i koduar “Zmeja”. Si rezultat, u bë lokalizimi dhe ndalimi i automjetit të dyshuar. Gjatë kontrollit në automjetin tip “Opel”, me drejtues shtetasin R. L. dhe pasagjer shtetasin K. Z., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 10 thasë me lëndë të dyshuar narkotike kanabis, me peshë totale 36 kilogramë. Në vijim të operacionit, në bashkëpunim me shërbimet e Policisë së DVP Dibër, është ushtruar kontroll në banesën e shtetasit R. L., në fshatin Zall Dardhë, Dibër, ku janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri kallashnikov, një pistoletë shenjëdhënëse dhe municion luftarak. Në përfundim të veprimeve të para hetimore u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve: R. L., 28 vjeç, banues në Zall Dardhë, Dibër dhe K. Z., 28 vjeç, banues në Kamzë, Tiranë. Nën drejtimin e Prokurorisë, vijon puna për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, kryer në bashkëpunim dhe “Armëmbajtja pa leje”.

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

> Arkiva

> Akademia e Sigurisë

> Ministria e Brendshme

> Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

> Interpol

> Europol

> Misioni PAMECA V

> SCPA

> Projekti Trivalent